



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 1335 Prot.

Tiranë, më 11.02.2016

U DH Ë Z I M

Nr. 1, datë 11.02.2016

PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS
SHTETËRORE
2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26 dhe nenit 51, të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2016 për shkollat e mesme joprofesionale të jenë:
 - a. Provime të detyruara:
Gjuhë shqipe dhe Letërsi
Matematikë
Gjuhë e huaj
 - b. Provime me zgjedhje
- 1.1 Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor B1.
- 1.2 Lista e gjuhëve të huaja, që jepen si provim i detyruar D3, është: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Gjuha e huaj që jepet provim, pasqyrohet në Formularin A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të Maturës Shtetërore 2014 dhe 2015), që rezultuan mbetës në D3, duhet të rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë, që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rijapin provimin e detyruar D3.

2. Provimet me zgjedhje

2.1 Lista e lëndëve të provimeve me zgjedhje të jetë:

Nr	Lënda	Kredite
I. Për shkollat e mesme		
1.	Gjuhë e huaj	10
2.	Letërsi e thelluar	5
3.	Matematikë e thelluar	5
4.	Kimi bërthamë	4
5.	Kimi e thelluar	6
6.	Fizikë bërthamë	4
7.	Fizikë e thelluar	6
8.	Biologji bërthamë	4
9.	Biologji e thelluar	6
10.	Histori bërthamë	5
11.	Histori e thelluar	9
12.	Gjeografi bërthamë	5
13.	Gjeografi e thelluar	7
14.	Ekonomi bërthamë	2
15.	Ekonomi e thelluar	4
16.	Teknologji bërthamë	2
17.	Teknologji e thelluar	4
18.	Qytetari	3
19.	Psikologji	2
20.	Filozofi	2
21.	Sociologji	2
II. Vetëm për shkollat artistike		
22.	Histori muzike	6
23.	Histori arti	6
24.	Histori baleti	3

2.2 Testi i gjuhës së huaj me zgjedhje hartohet në nivelin gjuhësor B2.

2.3 Lista e gjuhëve të huaja, si lëndë me zgjedhje, përcaktohet në udhëzimin për plotësimin e formularit A1/A1Z.

2.4 Programet orientuese të lëndëve të detyruara (Gjuhë shqipe dhe Letërsi, Matematikë dhe Gjuhë e huaj), për të gjithë maturantët/kandidatët, janë në përshtatje me programet ekzistuese të shkollave të mesme.

2.5 Programet orientuese të lëndëve me zgjedhje janë të njëjta për të gjithë maturantët/ kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z.

- 2.6 Programi orientues i një lënde të thelluar përmban edhe programin e lëndës bërthamë (përfshijë lëndët e provimeve të detyruara).
- 2.7 Lënda "Gjeografi" (bërthamë dhe e thelluar) përmban edhe lëndën "Shkenca e tokës".
- 2.8 Maturanti/kandidati zgjedh dy lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse i ka zhvilluar ose jo, apo i janë ofruar ose jo ato nga shkolla në programin mësimor.
3. Maturanti/kandidati zgjedh lëndët për provimet me zgjedhje sipas këtyre kriterëve:
- Shuma e krediteve të këtyre lëndëve të jetë jo më e vogël se 8 (tetë).
 - Numri i lëndëve të jetë 2 (dy).
 - Nga "Lista e lëndëve me zgjedhje", maturanti i shkollave artistike, koreografike ka të drejtë të zgjedhë:
 - Lëndën e parë, nga grupi i lëndëve "II. Vetëm për shkollat artistike".
 - Lëndën e dytë, nga grupi i lëndëve "I. Për të gjitha shkollat e mesme".
 - Maturanti/kandidati, kur zgjedh një lëndë të thelluar, nuk mund të zgjedhë njëkohësisht të njëjtën lëndë bërthamë (përfshijë lëndët: Gjuhë shqipe dhe Letërsi, Matematikë dhe Gjuhë e huaj).
4. Kandidati, që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50, (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t'i rijapë më.
5. Kandidatët, të cilët:
- rezultojnë mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore, duhet t'i rijapin ato që të pajisen me diplomë.
 - nuk kanë dhënë provimet me zgjedhje ose nuk kanë rezultuar kalues, por janë të pajisur me dëftesë pjekurie, do t'i japin ato në përputhje me këtë Udhëzim.
6. Kandidatët, që në Maturën Shtetërore 2012 kanë zgjedhur për të dhënë 3 (tri) provime me zgjedhje dhe:
- kanë mbetur në dy provime, të zgjedhin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij Udhëzimi.
 - rezultojnë kalues në dy prej tyre, të pajisen me diplomën e maturës.
7. Kandidatëve, të cilët kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2006 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime universitare, t'u njihen dy nga provimet e detyruara që përputhen me D1 dhe D2, ose provimet e njëvlefishme me to, të njehsuara nga DAR/ZA-të. Përveç kësaj, ata duhet të japin provimet me zgjedhje mbështetur në këtë Udhëzim.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Komiteti i Maturës Shtetërore, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Inspektoriat Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR



LINDITA NIKOLLA

